

THIRRJE PËR OFERTË

Titulli i Projektit:

“Forcimi i Privatësisë dhe Sigurisë së të Dhënave për Grupet Vulnerabël në Tiranë”

Projekti ka si synim forcimin dhe mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë së të dhënave personale për grupet vulnerabël në Tiranë, duke rritur ndërgjegjësimin, aftësitë dhe kapacitetet e tyre për të menaxhuar dhe mbrojtur informacionet sensitive. Nëpërmjet këtij projekti synohet të kontribuohet në krijimin e një kulture të sigurisë së të dhënave të përputhur me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në reduktimin e rrezikut të abuzimit apo keqpërdorimit të tyre.

1. Thirrje për kompani IT – Krijimi dhe mirëmbajtja e Platformës Online

Aktiviteti 2.1:

Krijimi dhe Zhvillimi i Platformës Online për Edukimin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Kompania fituese do të zhvillojë një platformë online interaktive që do të shërbejë si burim qendror për informacion mbi mbrojtjen e të dhënave. Platforma do të përfshijë:

- Materiale edukative (video trajnimi, artikuj, infografika, materiale ndërgjegjëse).
- Seksion për pyetje dhe përgjigje.
- Hapësirë për ndarjen e përvojave personale dhe sfidave.

Platforma do të garantojë akses të vazhdueshëm për qytetarët, duke mundësuar të mësojnë në ritmin e tyre dhe duke shërbyer si burim për ata që nuk kanë mundësi të marrin pjesë në trajnime fizike.

Rezultatet e pritshme:

- Minimumi 20 materiale edukative të publikuara.
- Minimumi 1,000 vizitorë të regjistruar deri në përfundim të projektit.

Kushte të përgjithshme për kompanitë ofertuese:

1. Të jenë subjekte të regjistruara me objekt shërbimi në fushën përkatëse.
2. Dorëzimi i ofertës të kryhet vetëm me email në adresën: **info@ilp-al.org** ose me postë (nuk pranohen oferta dorazi).
3. Paga do të kryhet pas përfundimit dhe dorëzimit të shërbimit.
4. Operatorët ekonomikë duhet të përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara nga organizata zbatuese.

5. Kompania duhet të sigurojë **domain dhe hosting aktiv për një periudhë minimale prej 1 (një) muaji.**

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- NIPT / Ekstrakti i QKR-së.
- Ofertë financiare për krijimin e domain-it, hosting dhe platformës (në ALL, me TVSH të përfshirë).
- Të dhënat e personit të kontaktit dhe IBAN i kompanisë.

Thirrje për Ekspert për menaxhimin e përmbajtjes në Platformën Online

Përveç zhvillimit të platformës, projekti kërkon angazhimin e një eksperti individual që do të mbështesë procesin e **hedhjes së përmbajtjes** në platformën online të krijuar.

Detyrat kryesore të ekspertit:

- Hedhja dhe organizimi i materialeve të gatshme edukative në platformë.
- Bashkëpunimi me kompaninë IT për përdorimin e formateve të përshtatshme.
- Sigurimi që përmbajtja të publikohet sipas standardeve teknike të platformës.
- Koordinimi me organizatën dhe ekspertët e fushës për të garantuar saktësinë dhe funksionalitetin e materialeve të publikuara.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Eksperiencë e mëparshme në menaxhimin e përmbajtjes online ose sistemeve digjitale.
- Njohuri të mira mbi mirëqenien dhe sigurinë personale.
- Preferohen kandidatë me eksperiencë në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile dhe institucione publike.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Ofertën Financiare.
2. Curriculum Vitae (CV).
3. Letër interesi.